



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

catalyst



FONDACIONI KOSOVAR PËR SHOQËRI CIVILE
KOSOVAR CIVIL SOCIETY FOUNDATION

Thirrje për organizata të shoqërisë civile (OShC)

TRAJNIM BAZIK PËR DIVERSIFIKIM DHE NGRITJE TË FONDEVE

Qëndrueshmëria financiare e organizatave të shoqërisë civile (OShC) është një ndër sfidat kryesore të zhvillimit të mirëfilltë të aktivizmit dhe shoqërisë civile. Në Kosovë, përkrahja më e madhe financiare për OShC vjen nga donatorët e huaj dhe fondet publike. Përkrahja si e tillë, e varur kryesisht nga dy burime të vetme të financimit, rrezikon qëndrueshmërinë e shoqërisë civile. Andaj, është e domosdoshme që të eksploroohen mundësitë tjera të financimit dhe diversifikimit të resurseve.

Llojllojshmëria e resurseve financiare dhe jo-financiare nënkupton identifikimin dhe mobilizimin e mbështetjes alternative financiare, si dhe kontributin përmes mbështetjes vullnetare nga qytetarët, sektori privat, ekspertët në Kosovë dhe diasporë. Kjo do të mundësonte që OShC-të të jenë më të suksesshme në zbatimin e misionit të vet, të fuqizojnë lidhjen me konstituencën, si dhe të rrisin llogaridhënien dhe transparencën në raport me qytetarët.

Me qëllim që të adresojë çështjen e qëndrueshmërisë së burimeve të organizatave të shoqërisë civile, Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) përmes **Programit për Angazhim Qytetar (CEA)** të cilin e zbaton në partneritet me misionin e USAID në Kosovë, fton OShC-të dhe grupet joformale të aplikojnë për trajnimin bazik një-ditor për diversifikim dhe ngritje të fondeve.

Trajnimi bazik do të ofrohet nga grupi i trajnerëve dhe mentorëve profesionistë të trajnuar nga KCSF dhe Catalyst Balkans.

Trajnimi bazik do të jetë niveli i parë i ciklit të trajnimeve në qëndrueshmërinë financiare të organizatave të shoqërisë civile, dhe si i tillë do të jetë obligativ në vazhdimin e ndjekjes së niveleve tjera të trajnimit, si: trajnimet e avancuara dhe mentorim i drejtpërdrejtë për ngritje të fondeve për organizatën.

Trajnimi do të mbahet në disa qytete të Kosovës, si në vijim:

- Në Prishtinë, në gjuhën shqipe, më 14 mars 2023
- Në Graçanicë, në gjuhën serbe, më 14 mars 2023;
- Në Prizren, në gjuhën shqipe, më 16 mars 2023;
- Në Pejë, në gjuhën shqipe, më 16 mars 2023.

Çka përfitoni nga ky trajnim?

Qëllimi kryesor i këtij trajnimi është rritja e kapaciteteve të OShC-ve dhe të aktivistëve të shoqërisë civile mbi modelet e ngritjes së fondeve, si dhe sigurimin e një qëndrueshmërie më të madhe në punën e tyre, në komunitetet ku veprojnë. Përmes një kurrikule të dizajnuar për nevojat e OShC-ve në Kosovë, ju do të përfitoni njohuri mbi:

- Hulumtimin dhe identifikimin e burimeve të ndryshme për financimin e punës së organizatës tuaj;
- Analizën e modeleve të ndryshme të ngritjes së fondeve, si: ngritja e fondeve përmes dhurimeve, pagesë të anëtarësisë, fushatave individuale dhe targetuara për ngritje të fondeve, partneriteteve ndër-sektoriale, kutive të donacioneve, fushata digjitale, etj.;
- Ndërtimin e partneriteteve me donatorët nga komuniteti i biznesit;
- Përgatitjen e fushatave dhe ngjarjeve për të mobilizuar fonde;
- Mjetet dhe format më adekuate për mbledhjen e fondeve nga individët dhe bizneset;



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

catalyst



- Mobilizimin e diasporës në ngritje të fondeve;
- Përdorimin e teknologjisë për të mobilizuar burime;
- Mbi të gjitha, mundësi për të aplikuar në trajnimet e avancuara për ngritje të fondeve dhe mentorimin e drejtpërdrejtë që do të ofrohet nga ekspertët e CEA.

Kush mund të aplikojë dhe cilat janë kriteret e aplikimit?

Të drejtë aplikimi kanë organizatat e shoqërisë civile të cilat kanë interesim dhe vendosmëri për të mësuar forma të reja të ngritjes së fondeve për organizatën apo komunitetin e tyre.

Secila OShC duhet të propozojë 1 anëtar të stafit bazuar në përgjegjësitë e tyre brenda organizatës për të marrë pjesë në trajnim.

Kriteret e aplikimit:

- ✓ Të jetë Organizatë e Shoqërisë Civile, e regjistruar në Kosovë, apo grup jo-formal që vepron në Kosovë;
- ✓ Të jetë Organizatë e Shoqërisë Civile që vepron kryesisht në nivel lokal;
- ✓ Të ketë identifikuar si nevojë zhvillimin e kapaciteteve për forma alternative të ngritjes së fondeve për organizatën apo komunitetin në të cilin operon;
- ✓ Të ketë aktivitet në komunitet dhe/ose interesim për përfshirje të qytetarëve/eve në punën e organizatës;
- ✓ Anëtari/ja e stafit që aplikon duhet të jetë përgjegjës për ngritje të fondeve për organizatën.

KCSF inkurajon gjithëpërfshirje nga aspekti gjinor, i etnisë, përfaqësimit gjeografik nga të gjitha rajonet e Kosovës.

Si të aplikoni?

Aplikimi bëhet duke plotësuar formën elektronike në vegëzën në vijim:

- Për trajnimin në Prishtinë: <https://bit.ly/3YI6LbL>
- Për trajnimin në Graçanicë: <https://bit.ly/3KlbTyv>
- Për trajnimin në Prizren: <https://bit.ly/3I7chh2>
- Për trajnimin në Pejë: <https://bit.ly/3YZtU9y>

Formulari i aplikimit mund të plotësohet në gjuhën shqipe ose serbe.

Vetëm aplikantët që përmbushin kriteret e përcaktuara do të kontaktohen për pjesëmarrje në trajnim, ku do të njoftohen edhe zyrtarisht për detaje logjistike.

Në rast të pranimit të shumë aplikacioneve, përparësi do të kenë organizatat që kanë aplikuar të parat.

❖ **Afati i fundit për aplikim: 1 mars 2023.**

Informata logjistike

Kandidatët/kandidatet e përzgjedhur/a do t'u kërkohet të jenë fizikisht të pranishëm në trajnim. Shpenzimet e transportit dhe ushqimit do të mbulohen nga KCSF.

Për informata tjera, ju lutem na kontaktoni në adresën elektronike info@kcsfoundation.org ose përmes telefonit në numrin: 038 600 334.